



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/96


Datë: 22.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet me vërejtje Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal.
2. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit dhe Ministria e Financave për përfshirjen e vërejtjeve në tekstin e Projektligjit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/96

Datë: 22.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-120.
2. Obligohet Ministria e Infrastrukturës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/96

Datë: 22.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Rregullimin e Profesionit të Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/96


Datë: 22.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes financiare për IPA 2017 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
2. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian të ndërmarrë të gjitha hapat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/96

Datë: 22.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Caktohet Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës në cilësinë e zyrtarit Përgjegjës për Programin Shtetëror të Sigurisë së Aviacionit Civil në Republikën e Kosovës.
2. Themelohet Komiteti për Programin Shtetëror të Sigurisë së Aviacionit Civil në Republikën e Kosovës me këtë përbërje:
 - 2.1. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil - udhëheqës;
 - 2.2. Drejtori i Departamentit të Aviacionit Civil në Ministrinë e Infrastrukturës - anëtar;
 - 2.3. Kryesuesi i Komisionit për hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike - anëtar;
 - 2.4. Kryeshefi i Agjencisë për Menaxhim Emergjent - anëtar;
 - 2.5. Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të navigacionit Ajror - anëtar.
3. Zyrtari Përgjegjës për Programin Shtetëror të Sigurisë së Aviacionit Civil është Përgjegjës të Koordinojë të gjitha aktivitetet e nevojshme për zbatimin e Programit Shtetëror të Sigurisë së Aviacionit Civil, siç janë definuar me Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe me Standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, si dhe të hartojë përshkrimin e detyrave të punës së Komitetit për Programin Shtetëror të Sigurisë së Aviacionit Civil.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/96

Datë: 22.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjetet financiare në vlerë 16.000 (gjashtëmbëdhjetëmijë) euro në bazë të kërkesës së OJQ "Ustrajnost" me nr. të protokollit 1759, të datës 30.05.2016.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, kodi buxhetor 15600, dhe do të shfrytëzohen për manifestimin e Ditës së komunitetit Goran në Kosovë.
3. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi barten në llogarinë e OJQ "Ustrajnost" në Bankën Ekonomike me numër të xhirrollogarisë: 1404000003790983.
4. Obligohet Zyra për Buxhet dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
5. Obligohet përfituesi që brenda dy muajve të raportojë dhe të ofrojë dëshmi (kupon fiskal dhe dëshmi tjera) në Zyrën për Çështje të Komuniteteve për realizimin e projektit.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/96

Datë: 22.06.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.04/L-216 për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Trajtimin e Kafshëve të Konfiskuara të cilat dyshohen që janë të Kontrabanduara

Neni 1

Caktohet Strehimorja e përkohshme për vendosjen dhe trajtimin e kafshëve të gjalla (dema, lopë, viça) të konfiskuara të cilat dyshohen që janë të kontrabanduara, e cila do të veprojë nën autoritetin e Drejtorisë së Qendrës Korrektuese të Dubravës (në tekstin e mëtejme "Strehimorja").

Neni 2

Strehimorja për llogari të këtij vendimi është objekti aktual i stallës në perimetrin e burgut të Dubravës në Dubravë të komunës së Istogut, në të cilën duhet të vendosen dhe trajtohen kafshët e konfiskuara të cilat dyshohen së janë kontrabanduar.

Neni 3

Në rastet e kontrabandimit kafshët e konfiskuara do të trajtohen nga Dogana e Kosovës dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, konform dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 4

Transporti i kafshëve të konfiskuara nga vendi ku konfiskohen e deri të strehimorja bëhet nga kompania të cilën e kontraktin Dogana e Kosovës në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

1. Në rast së procedura e shitjes së kafshëve në momentin e konfiskimit nuk ka përfunduar nga Dogana e Kosovës, atëherë Dogana e Kosovës kafshët e konfiskuara i vendos në

Strehimore dhe të njëjtat menaxhohen gjatë tërë procesit (kafshët e gjalla dhe mishi) nga Drejtoria e Burgut të Dubravës në pajtim me rregulloret e brendshme të SHKK-së.

2. Në rast të konfiskimit të shpezëve, shpezët asgjësohen pas marrjes së aktvendimit nga Dogana e Kosovës.

Neni 6

Pas kryerjes së procedurave dhe marrjes së aktvendimit nga ana e Doganës së Kosovës, AUV do të bëjë inspektimin e kafshëve të konfiskuara si dhe do të specifikojë procedurat e shitjes së mallit të konfiskuar në pajtim me legjislacionin në fuqi si: lloj i mishit apo kafshës së gjallë, pesha dhe gjendja shëndetësore e kafshës.

Neni 7 Kompensimi

Në rast kur çështja lidhur me kafshët e konfiskuara nga Dogana, zgjidhet përfundimisht në instancë të fundit gjyqësore sipas mjetit të ushtruar në favor të apeluesit, Dogana e Kosovës i kompenson pronarit të kafshëve të konfiskuara shumë siç parashihet me nenin 292 të Kodit Doganor të Akcizave të Kosovës.

Neni 8

Obligohen Autoritetet e përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit - MIK dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 9

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë